

**Njoftim i përqendrimit me të cilin Avengiro s.r.o. Çeki do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi
Avenga Holding DOO Luksemburg**

(lënda nr. 08-185/2023)

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë “ Nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18), më 29.12.2023, te Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar njoftim i përqendrimit me të cilin Avengiro s.r.o. (Avengiro sr.o.) me seli në Vinohradka 1511/230, 100 00 Pragë 10, Republika Çeke, e kontrolluar plotësisht nga Arikoma Grup Holding a.s. (Aricoma Group Holding a.s) në pronësi të Grupit KKCG (KKCG Group), synon të fitojë kontrollin e plotë të Avenga Holding DOO (Avenga Holding S.à rl.) me seli në 26A Boulevard Royal L-2449 Luksemburg.

Pjesëmarrësit në përqendrim dhe aktivitetet e tyre të biznesit

Avengiro s.r.o është pjesë e Grupit KKCG, një grup privat investimesh me më shumë se 6,000 punonjës, i cili operon në 18 vende kryesisht aktivë në fushat e mëposhtme:

- argëtim dhe lojëra: punë lotarie dhe lojëra bastesh, gërvishitje dhe platforma lojërash online;
- naftë, gaz natyror dhe inxhinieri: në veçanti, kërkimi i naftës dhe gazit, prodhimi dhe tregtia, shpimi dhe riparimi i puseve, ndërtimi dhe funksionimi i depove nëntokësore të gazit natyror, prodhimi dhe shitja e metanolit; në inxhinieri mekanike, ai fokusohet kryesisht në pajisje industriale, tuba përcjellëse, komponentët e kanalit dhe instalimin e tubave për ndërtimin dhe rindërtimin e njësive investuese;
- teknologji: ofrimi i shërbimeve IT, investimi në startup-et teknologjike dhe kërkimi, zhvillimi dhe shitja e pajisjeve inovative mjekësore për të ndihmuar pacientët të qëndrojnë aktivë dhe të vetë-mjaftueshëm (bioteknologji); dhe
- Pasuri të paluajtshme: Zhvillimi komercial dhe i banimit.

Në Republikën e Maqedonisë së Veriut, Grupi KKCG është prezent në tregun e terminaleve të video lotarisë dhe teknologjisë informatike përmes kompanive të mëposhtme:

- Shoqëria për organizimin e lojërave të fatit KASINOS AUSTRIA INTERNATIONAL MAKEDONIA DOO Shkup, me aktivitet prioritar - aktivitetet e lojërave të fatit dhe basteve;
- Shoqëria për organizimin të lojërave të fatit Video Lotaria Shtetërore e Republikës së Maqedonisë - KASINOS AUSTRIA DOO Shkup, me veprimtari prioritare - aktivitetet e lojërave të fatit dhe basteve;
- Kinshift DOOEL Shkup, më parë i njohur si Seavus DOOEL Shkup me aktivitet prioritar - programim kompjuterik; dhe
- Shoqëria për Edukimin Kompjuterik dhe Zhvillimin e Inovacioneve Kinshift Akademi DOOEL Shkup, më parë e njohur si Qendër Edukative dhe Zhvillimore Seavus DOOEL Shkup, me aktivitet prioritar - arsim tjetër që nuk përmendet diku tjetër;
- Shoqëria për prodhim, tregti dhe shërbime Musala Soft DOOEL Shkup - me veprimtari prioritare - programim kompjuterik.

Avenga Holding DOO është një kompani holding e subjekteve të ndryshme juridike ndërkombëtare (Avenga dhe filialet e saj, së bashku "Avenga Group") ofron shërbime komplekse inxhinierike softuerike, shpërndarje të projekteve komplekse/të mëdha softuerike dhe konsulencë IT. Grupi

Avenga ka selinë në Gjermani dhe ka zyrat e saj kryesore të vendosura në Gjermani, Poloni, Ukrainë, SHBA, Malajzi, Maltë dhe Argjentinë.

Sipas parashtruesit, tregu relevant i produkteve mund të përkufizohet si tregu i shërbimeve të teknologjisë së informacionit („IT“) në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Në bazë të shqyrtimit paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të paraqesin vërejtjet dhe mendimet në lidhje me këtë përqendrim të Komisioni. Vërejtjet dhe mendimet e palëve të treta të interesuar mund të dërgohen edhe me faks: 02 3296 466, në adresën: rr. Shën Kirili dhe Metodi nr. 54, Shkup ose me email: kzk@kzk.gov.mk dhe të njëjtat duhet të arrijnë të Komisioni në afat prej 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

04.01.2024

Shkup